



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION
MINISTARSTVO PROSVETE, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJA

Module tematike për mbrojtjen e fëmijës

(Konteksti i shkollës)



Prishtinë, 2023

Ky manual është mbështetur nga Care International në Ballkan së bashku me partnerët SIT dhe YMCA, përmes fondeve nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Ministrisë së Edukimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë dhe jo domosdoshmërisht reflekton pozitën e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Përmbajtja:

Hyrje	4
Mundësitë kurrikulare	6
<i>Modulet tematike:</i>	
• MODULI 1. Parandalimi dhe referimi i dhunës në shkolla	9
• MODULI 2. Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës	12
• MODULI 3. Mbrojtja e fëmijëve në internet	15
• MODULI 4. Parandalimi i diskriminimit në shkolla	18
• MODULI 5. Promovimi i barazisë gjinore	21
• MODULI 6. Parandalimi i gjuhës së urrejtjes	23
• MODULI 7. Parandalimi i dhunës në familje	25
• MODULI 8. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve	28
• MODULI 9. Parandalimi i ngacmimeve seksuale	30
• MODULI 10. Programi i iniciativës së të rinjve - Y Rinia	33
• MODULI 11. Parandalimi i martesave të hershme	36
• MODULI 12. Parandalimi i punës së fëmijëve	39
Përdorimi i moduleve në trajnimet e mësimdhënësve	43
Përfundim	46

HYRJJE

Në këtë pako modulesh janë ofruar informacione bazike mbi temat e ndërlidhura me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe rolin e shkollës në trajtimin e tyre. Temat e parandalimit të dhunës, braktisjes, rreziqeve në internet, diskriminimit, dhunës me bazë gjinore, trafikimit, martesave të hershme, punës së rrezikshme etj., janë me interes që të trajtohen nëpërmjet arsimit cilësor, sepse parandalimi dhe reagimi ndaj tyre krijojnë mundësi dhe favore në arritjen e rezultateve të fëmijëve, siç kërkohen nga kurrikulat në nivele të ndryshme arsimore. Rezultatet mësimore janë qëllimi kryesor i institucioneve arsimore, por parandalimi i këtyre elementeve të rrezikshme dhe sfiduese është përgjegjësi dhe detyrim institucional thelbësor për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre të plotë në aspektin fizik, intelektual, social e emocional.

Kur fëmijët janë të rrezikuar ose të atakuar nga këto lloj problemesh, është e pamundur që ta kenë vëmendjen e duhur në procesin edukativ dhe arsimor. Të ndikuar nga rrethanat e ndryshme që e pengojnë zhvillimin e tyre, ata mund të ndryshojnë sjellje, qëndrime dhe, në shumicën apo edhe në të gjitha rastet, evidentohet rënie e rezultateve mësimore, por shpesh edhe përfshirje në dukuri negative, sjellje asociale, shprehje agresiviteti apo tërheqje në vete, izolim nga shoqëria, mosbashkëpunim me moshatarë dhe mësimdhënës e të tjera.

Modulet e ofruara brenda kësaj pakoje, siç mund ta shihni, janë në përputhje me kurrikulat arsimore dhe legjislativën në fuqi. Specifikisht, të gjitha ndërlidhen me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe detyrimet e institucioneve arsimore sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera që mund t'i shihni në linqet e vendosura në fund të secilit modul. Kështu, pakaja ofron mbështetje për stafin e shkollave tona, për të qenë brenda rolit që e kanë sipas politikave nacionale që i trajtojnë këto tema.

Pakaja përmban 12 module tematike, të cilave u paraprin kaptina mbi ndërlidhjen me kurrikulat tona arsimore dhe përmbillet me mundësinë e trajtimit të tyre edhe përmes trajnimit, përfshirë atë me bazë në shkollë.

Dymbëdhjetë modulet tematike janë si në vijim:

- Moduli 1. Parandalimi dhe referimi i dhunës në shkollë
- Moduli 2. Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës
- Moduli 3. Mbrojtja e fëmijëve në internet
- Moduli 4. Parandalimi i diskriminimit në shkollë
- Moduli 5. Promovimi i barazisë gjinore
- Moduli 6. Parandalimi i gjuhës së urrejtjes
- Moduli 7. Parandalimi i dhunës në familje
- Moduli 8. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve
- Moduli 9. Parandalimi i ngacmimeve seksuale
- Moduli 10. Programi i iniciativës së të rinjve - Y Rinia
- Moduli 11. Parandalimi i martesave të hershme
- Moduli 12. Parandalimi i punës së fëmijëve

*Përveç elementeve kryesore mbi rolin e shkollave në trajtimin e këtyre temave dhe reagimin ndaj rrethanave që ndërli-
hen me to, në fund të moduleve janë ofruar burime të tjera të materialeve që mund të përdoren sipas zgjedhjes dhe
kreativitetit të mësimitdhënësve. Materialet mbështetëse, përveç informuese dhe orientuese për punën e stafit shkollor,
janë edhe nxitëse e motivuese për punën edhe më cilësore që mund ta bëjnë mësimitdhënësit, në suazat e fleksibilitetit
që e kanë në përcaktimin e temave dhe metodologjisë së realizimit të aktiviteteve mësimore.*

*Duke qenë se stafi i ministrisë vazhdimisht krijon materiale të reja dhe validon materiale të organizatave partnere, kjo
pako do të plotësohet e pasurohet vazhdimisht.*

Me dashamirësi!

Autoret: Merita Januzi, Azize Sekiraqa

Shqipe Gashi, Habibe Buzuku

Mundësitë kurrikulare

Temat që kanë të bëjnë me parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkolla; parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës nga nxënësit; mbrojtjen në internet; parandalimin e dhunës në familje; parandalimin e diskriminimit; promovimin e barazisë gjinore; parandalimin e gjuhës së urrejtjes; parandalimin e trafikimit; parandalimin e ngacmimeve seksuale; vetëdijesimin e të rinjve, e në veçanti të djemve, për mospërdorimin e dhunës në raport me femrat; parandalimin e martesave të hershme dhe parandalimin e punës së fëmijëve, janë tema që zënë vend të veçantë në dokumentet kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Parandalimi i dhunës promovohet përmes zhvillimit të sjelljeve pozitive që nxënësit dhe njerëzit në përgjithësi shfaqin në familje, shkollë, vende pune, sheshe dhe mjedise të ndryshme, në raport me veten, të tjerët dhe mjedisin.

Gjithashtu dokumentet kurrikulare u mundësojnë nxënësve që të njohin dhunën si koncept në aspektin akademik, çka nënkuptohet me të, cilat janë shkaqet dhe si mund të evitohen, si të trajtohet, parandalohet dhe raportohet ajo. Pastaj, cilët janë personat dhe institucionet që e trajtojnë atë dhe çfarë sjelljesh duhet manifestuar në situata të ndryshme jetësore?

Dokumentet kurrikulare lejojnë hapësirë të mjaftueshme që temat e tilla të mund të trajtohen gjatë mësimit të rregullt në klasë përmes çështjeve/temave ndërkurrikulare dhe mësimit me zgjedhje, si dhe gjatë aktiviteteve të lira – jashtëkurrikulare.

Qasja ndërkurrikulare

Temat e paraqitura në paketë mund të trajtohen nga të gjitha lëndët mësimore të të gjitha fushave kurrikulare, me përmbajtjet e tyre mësimore dhe nga këndvështrime të ndryshme, si në vijim:

Përmes lëndëve mësimore të fushës kurrikulare *Gjuhët dhe komunikimi*, nxënësve mund t'u ofrohen tekste letrare dhe joletrare që përshkruajnë të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, dhe t'u jepet hapësirë për të analizuar përmbajtjet në kontekstin e kohës, vendit, kulturës, institucioneve, sjelljeve etj.

Përmes lëndëve mësimore të fushës kurrikulare *Artet*, nxënësit mund të aftësohen të komunikojnë me të tjerët, të shfaqin emocionet, porositë, informacionet për çështje e situata të ndryshme jetësore përmes veprave të artit figurativ dhe muzikor.

Përmes lëndëve të fushës kurrikulare *Matematikë*, nxënësit mund të aftësohen të gjykojnë dhe të gjejnë zgjidhje për çështje të ndryshme shoqërore duke përdorur të dhënat numerike, si p.sh. për çështjet që kanë të bëjnë me gjininë, braktisjen, trafikimin dhe dhunën në përgjithësi, të shkaktuara nga faktori njeri, po edhe për çështjet pozitive si kundërpërgjigje ndaj tyre.

Përmes lëndëve të fushës kurrikulare *Shkencat e natyrës*, nxënësit mund të marrin njohuri dhe të zhvillojnë shkathtësi për kujdesin ndaj trupit të tyre, për sjelljet ndaj vetes dhe trajtimin nga të tjerët dhe për të tjerët, për substancat kimike, për veprimet e ndryshme fizike dhe pasojat e tyre, etj.

Përmes lëndëve të fushës kurrikulare *Jeta dhe puna*, nxënësit mund të aftësohen që të kuptojnë rëndësinë që ka puna për mirëqenien individuale dhe kolektive, pastaj që të trajtojnë të mirat dhe të këqijat që ka teknologjia, në veçanti teknologjia e informacionit, për rreziqet, përdorimin e drejtë të saj, si të gjenden në situata të ndryshme jetësore etj.

Përmes fushës kurrikulare *Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti*, nxënësit mund të aftësohen dhe të përgatiten që të bëjnë jetë të shëndetshme dhe të sigurt, duke trajtuar tema dhe bërë aktivitete fizike, në veçanti aktivitete që i aftësojnë si të mbrohen në raste rreziku të shkaktuara nga faktori njeri.

Te lëndët e fushës kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi*, u jepet hapësirë e madhe temave të tilla, në aspektin përmbajtjesor. Në Arsimin Fillor ato trajtohen përmes lëndës mësimore *Shoqëria dhe mjedisi*, në Arsimin e Mesëm të Ulët përmes lëndëve *Edukatë qytetare, Histori dhe Gjeografi*, dhe në Arsimin e Mesëm të Lartë, pos lëndëve të cekura më lart, ato trajtohen edhe përmes *Psikologjisë, Sociologjisë dhe Filozofisë*. Tema e dhunës trajtohet në kuadër të të gjitha koncepteve të kësaj fushe, si: Individu, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore; Proceset shoqërore dhe natyrore; Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë; Vendimmarrja dhe institucionet; Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Ato mund të trajtohen në kontekstin e sjelljeve, bindjeve, qëndrimeve, emocioneve individuale e kolektive, kulturave, normave, legjisllacionit, kohës dhe vendit, etj. Shih: <https://masht.rks-gov.net/category/arsimi-parauniversitar/>.

Mësimdhënësit i mbetet për detyrë që të identifikojë rezultatet e të nxënësve të lëndës, të cilat do të synojë t'i arrijë me nxënës dhe mbi bazën e tyre të përcaktojë përmbajtjet – njësitet, mjetet dhe materialet mësimore, të cilat u përshtaten moshës së nxënësve. (Shumicën e tyre i gjeni në paketën e moduleve dhe jo vetëm.)

Qasja përmes mëimit me zgjedhje dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare

Pos lëndëve të rregullta mësimore, temat e tilla mund të trajtohen edhe përmes lëndëve mësimore me zgjedhje. Mësimdhënësit mund t'i marrin të gatshme materialet e ofruara në këtë paketë dhe/apo t'i përshtatin me nevojat dhe interesat e nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Për të përdorur këto materiale për mësimin me zgjedhje, duhet të kalohet në procedurat që parashihen me Udhëzimin Administrativ për mësimin me zgjedhje. Shih: <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-11-2023-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-arsimin-parauniversitar/>.

Aktivitet jashtëkurrikulare mund të realizohen duke shënuar data të caktuara, duke bërë fushata dhe projekte të ndryshme vetëdijesuese, aktivitete ndërmjetësuese dhe bashkëpunuese brenda shkollës dhe jashtë saj. Po ashtu mund të bashkëpunohet me komunitetin dhe institucionet përgjegjëse. Shih: <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-02-2016-dt-12-01-2016-aktivitetet-jashteshkollore-25-faqe>.

Qasja metodologjike

Krahas trajtimit përmbajtjesor të temave të cekura në këtë paketë të moduleve, sugjerohet që në klasë të krijohet një klimë pozitive gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Të përdoren metodologji të mësimdhënies demokratike, ku nxënësit lirshëm mund të shprehin mendimet e tyre dhe mund të dëgjojnë mendimet e të tjerëve. Gjithash-

tu sugjerohet që të punohet me nxënës në drejtim të zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive për të gjykuar në mënyrë të pavarur për sjelljet, çështjet e dukuritë e ndryshme, të përdorin argumente, dhe që të jenë në gjendje të marrin vendime të duhura në raste dhe situata të ndryshme jetësore.

Pjesëmarrja aktive e nxënësve në punë vullnetare në shkollë dhe jashtë saj, për temat e tilla, do të rrisë bashkëndjesinë dhe përgjegjësinë e tyre si qytetarë për të ndihmuar njerëzit që të kalojnë sfidat e ndryshme me të cilat përballen dhe për të kuptuar se angazhimi individual sjell të mira të përbashkëta.

Materialet e ofruara në paketë mësimdhënësit mund t'i përdorin si materiale plotësuese por edhe kryesore, në raste të caktuara, kur konsiderojnë se mund të përdoren si të tilla, në varësi të qëllimit të temës mësimore dhe në veçanti se cilat rezultate të lëndës dhe të kompetencave synojnë t'i arrijnë. Ato mund të merren në tërësi dhe pjesë-pjesë, si metodat e punës, fotot, videot, tregimet, detyrat, statistikën, linqet etj.



1 MODULI

**PARANDALIMI DHE REFERIMI
I DHUNËS NË SHKOLLA**

Pse ky modul?

Dhuna në shkolla është shqetësim i madh dhe ka ndikim të ndjeshëm negativ te nxënësit, stafi dhe mjedisi i përgjithshëm edukativ dhe mësimor. Është e domosdoshme që stafi i shkollës të marrë hapa për të parandaluar dhunën dhe t'i referojë nxënësit që mund të jenë në rrezik për t'u përfshirë në sjellje të dhunshme, në instancat e duhura. Ky modul ofron udhëzime për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla.

Parandalimi si shtyllë kryesore e sektorit të edukimit dhe arsimimit

Duke qenë se parandalimi i dhunës është esencial në kuadër të rolit të stafit të shkollës, ju inkurajojmë të ndiqni udhëzimet e vlefshme si në vijim:

- Zhvilloni një kulturë respekti dhe përfshirjeje në mbarë shkollën.
- Mbani aktivitete sensibilizuese kundër dhunës dhe sjelljeve konfliktuoze, përveç aktiviteteve të rregullta mësimore sipas kurrikulës.
- Krijoni një mjedis mësimor pozitiv që promovon respektin, mirësinë dhe përfshirjen.
- Inkurajoni fëmijët/nxënësit të pranojnë dallimet dhe të adresojnë menjëherë çdo rast diskriminimi ose ngacmimi.
- Inkurajoni sjelljen pozitive. Lavdërimi i fëmijëve/nxënësve për sjellje të mirë dhe përdorimi i një sistemi shpërblimesh dhe stimuluesh për veprime pozitive, mund të ndikojë në shprehitë e mira dhe motivimin e sjelljeve të shëndosha ndër moshatarë dhe në relacione të tjera.
- Ofroni shërbime mbështetjeje dhe këshillimi për nxënësit që mund të kenë probleme të shëndetit mendor ose sfida të tjera që mund të çojnë në sjellje të dhunshme. Nxitini ata të kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë për të.
- Jini të vetëdijshëm për atë që nxënësit po postojnë në platformat e mediave sociale dhe adresoni çdo postim që promovon dhunën ose gjuhën e urrejtjes! Informoni nxënësit se ata janë përgjegjës për atë që postojnë në rrjetet sociale dhe se kjo mund të ketë pasoja në shkollë dhe më gjerë.

Referimi dhe raportimi

Referimi dhe raportimi i dhunës është obligim ligjor dhe domosdoshmëri. Për të referuar rastet në nevojë për t'u trajtuar, fillimisht duhet njohur problematikën dhe hapat e veprimit, prandaj shih udhëzimet në vijim:

- Njihni shenjat paralajmëruese.
- Jini të vetëdijshëm për shenjat paralajmëruese që një fëmijë/nxënës mund të jetë në rrezik për t'u përfshirë në sjellje të dhunshme, të tilla si një ndryshim i papritur në sjellje ose në humor, izolim social ose kërcënime me dhunë.
- Merrni seriozisht të gjitha kërcënimet. Çdo kërcënim për dhunë duhet të merret seriozisht dhe duhet të ndërmerren veprimet e duhura. Raportoni menjëherë çdo kërcënim brenda shkollës, e cila sipas nevojës raporton tutje edhe në shërbimet e tjera, sipas legjislacionit në fuqi, specifikisht sipas *Protokollit për parandalim dhe referim të dhunës në IAP*.
- Ndiqni hierarkinë e raportimit sipas protokollit. Shkollat duhet të zbatojnë protokollin për raportimin dhe referimin e nxënësve që mund të jenë në rrezik për t'u përfshirë në sjellje të dhunshme, për të siguruar që fëmijë/nxënësit të marrin mbështetjen dhe ndërhyrjen e duhur.

- Nëse një nxënës rrezikohet të përfshihet në sjellje të dhunshme, është e rëndësishme të përfshihen prindërit ose kujdestarët e tij në procesin e referimit. Mbajini të informuar për situatën dhe punoni me ta për të zhvilluar një plan për trajtimin e çështjes.

Përfundim

Parandalimi dhe referimi i dhunës në shkolla kërkon një përpjekje të koordinuar nga stafi i shkollës, nxënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit. Duke krijuar një mjedis pozitiv mësimi; duke inkurajuar sjellje pozitive; duke ofruar shërbime mbështetëse dhe këshillimore; duke monitoruar mediat sociale; duke ditur shenjat paralajmëruese; duke i marrë seriozisht të gjitha kërcënimet; duke zbatuar protokollin dhe duke përfshirë prindërit dhe kujdestarët, mund të krijoni ambient të sigurt dhe miqësor për të gjithë fëmijët/nxënësit.

Linqe:

1. LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

2. RREGULLORE QRK- NR. 21/2013 PËR PROTOKOLLIN PËR PARANDALIMIN DHE REFERIMIN E DHUNËS NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

<https://masht.rks-gov.net/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referimin-e-dhunes-ne-institucionet-e-arsimit-para-universitar/>

3. UDHËZUES PËR ZBATIMIN E RREGULLORES NR. 21/2013

<https://masht.rks-gov.net/udhezus-per-zbatimin-e-rregullores-nr-21-2013/>

4. MANUAL DIDAKTIK PËR PARANDALIMIN E DHUNËS

[HTTPS://MASHT.RKS-GOV.NET/MANUAL-DIDAKTIK-PERPARANDALIMIN-E-DHUNES/](https://masht.rks-gov.net/manual-didaktik-per-parandalimin-e-dhunes/)

5. DORACAK PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA

<https://masht.rks-gov.net/doracak-per-parandalimin-e-dukurive-negative-ne-shkolla-te-mesme-te-larta/>

6. DORACAK PËR MËSIMDHËNËS ME AKTIVITETE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

<https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-me-aktivitete-mbi-te-drejtat-e-femijeve/>



MODULI

**PARANDALIMI DHE REAGIMI
NDAJ BRAKTISJES SË SHKOLLËS**

Pse ky modul?

Braktisja e shkollës është një shqetësim serioz që prek jo vetëm individin, por edhe komunitetin dhe shoqërinë në tërësi. Ajo ndikon negativisht në shanset e jetës së individit, perspektivat e punësimit dhe mirëqenien e përgjithshme. Si personel i shkollës, ju duhet të luani një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës. Ky modul udhëzues synon t'ju ofrojë informacion, strategji dhe mjete për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive braktisjes së shkollës.

Braktisja e shkollës është dukuria e largimit të nxënësve para përfundimit të shkollimit. Mund të ndodhë në çdo fazë të shkollimit, nga arsimi fillor deri në atë të mesëm. Arsyet e braktisjes së shkollës janë komplekse dhe të shumanshme dhe mund të kategorizohen në faktorë individualë, familjarë, shkollorë, socialë dhe komunitet. Disa nga arsyet e zakonshme të braktisjes së shkollës janë varfëria, problemet familjare, vështirësitë akademike, orientimi në profil të gabuar arsimor, mungesa e motivimit dhe mbështetja e pamjaftueshme.

Parandalimi i braktisjes së shkollës

Parandalimi i braktisjes së shkollës kërkon një qasje bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse që përfshin shkollën, familjen dhe komunitetin. Si staf i shkollës, ju mund të luani një rol vendimtar në parandalimin e braktisjes së shkollës duke e pasur funksional Ekipin për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (EPRBM) dhe së bashku duke i zbatuar politikatat nacionale arsimore. Në vijim i keni udhëzimet kryesore në vija të trasha, ndërkaq në linqet përkatëse i keni politikatat dhe instrumentet aktuale, të detajuara.

Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme është thelbësore, prandaj ndiqni udhëzimet si në vijim:

- Identifikoni fëmijë/nxënësit që janë në rrezik të braktisin herët shkollën dhe ndërhyjni në mënyra të duhura për t'i mbështetur ata.
- Krijoni një mjedis shkollor të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës që nxit angazhimin, motivimin dhe mësimin e nxënësve.
- Zhvilloni metodologji të mësimdhënies që është relevante, kuptimplote dhe tërheqëse, që plotëson nevojat dhe interesat e nxënësve të ndryshëm.
- Ofroni mundësi të personalizuar të të mësuarit që plotësojnë nevojat, interesat dhe stilet e të mësuarit individual të fëmijëve/nxënësve.
- Ndërtoni marrëdhënie të forta dhe pozitive me fëmijë/nxënësit, familjet dhe komunitetin më të gjerë dhe ofroni mbështetje sociale-emocionale për t'i ndihmuar fëmijët/nxënësit të kapërcejnë sfidat.

Pavarësisht masave parandaluese, disa nxënës mund të braktisin shkollën. Si staf i shkollës, ju mund t'i përgjigjeni braktisjes së shkollës në kohë dhe në mënyrë efektive duke zbatuar strategjitë e mëposhtme:

Ndërhyrja e hershme:

- Identifikoni nxënësit në rrezik të braktisjes sipas politikave të vendosura nga MASHTI (shih te linqet si funksionon sistemi), duke ndërmarrë masa për të motivuar qëndrimin e tyre në shkollë dhe zhvillimin brenda potencialit të plotë.
- Identifikoni nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe ndërhyri herët për t'i rikthyer ata në arsimim.
- Raportoni me saktësi në SMIA.
- Ofroni mbështetje të individualizuar për t'i ndihmuar fëmijë/nxënësit të kapërcejnë barrierat që çuan në braktisjen e tyre, si mbështetja akademike, këshillimi dhe mbështetja e familjes.
- Siguroni opsione alternative arsimore, të tilla si mësimi online, trajnimi profesional ose programet e arsimimit të të rriturve, për t'i ndihmuar fëmijë/nxënësit të përfundojnë arsimimin e tyre.
- Zhvilloni strategji riangazhimi, të tilla si programet e kontaktit, mentorimit dhe mbështetjes së kolegeve, për t'i ndihmuar fëmijët/nxënësit të kthehen në arsimim.

Përfundim

Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës është një përgjegjësi e përbashkët që kërkon një qasje bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse. Si personel i shkollës, ju duhet të luani një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës. Duke zbatuar strategjitë e përshkruara në këtë modul udhëzues, ju mund të ndihmoni që të gjithë fëmijët/nxënësit të kenë mundësinë për të përfunduar arsimimin dhe për të arritur potencialin e tyre të plotë.

Në vijim gjeni linqet me politikat aktuale për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes:

1. UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) Nr. 08-2018 PËR THEMELIMIN DHE FUQIZIMIN E EKIPEVE PËR PARANDALIM DHE REAGIM

<https://masht.rks-gov.net/udhezimi-adinistrativ-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu/>

2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZIA GJINORE

<https://masht.rks-gov.net/category/te-drejtat-e-njeriut/>



MODULI

**MBROJTJA E FËMIJËVE
NË INTERNET**

Pse ky modul?

Interneti është bërë pjesë integrale e jetës sonë dhe bashkë me të vijnë edhe rreziqe për fëmijët. Stafi i shkollës ka përgjegjësinë për të edukuar fëmijët se si të jenë të sigurt në internet dhe t'i mbrojnë ata nga rreziqet e mundshme. Ky modul është krijuar që të ofrojë udhëzime për stafin e shkollës, për të garantuar sigurinë e fëmijëve gjatë përdorimit të internetit.

Mbrojtja e fëmijës në internet nëpërmjet edukimit dhe arsimit

Stafi edukativ dhe arsimor duhet të ushtrorë rolin e vet në edukimin e fëmijëve/nxënësve për përdorim të internetit në mënyrë të dobishme (për qëllime mësimi, informimi, komunikimi e argëtimi brenda rregullave të sigurisë) dhe të përgjegjshme, pa abuzim me veten dhe të tjerët. Në këtë linjë keni disa nga udhëzimet kryesore, si në vijim:

- Hapi i parë është krijimi i një mjedisi të sigurt për fëmijët që të mësojnë dhe të ndërveprojnë në internet. Shkollat duhet të kenë filtra interneti dhe mure mbrojtëse për të parandaluar që fëmijët të kenë qasje në përmbajtje ose faqe interneti të papërshtatshme. Për më tepër, sigurohuni që fëmijët të përdorin aplikacione dhe faqe të medie sociale të përshtatshme për moshën e tyre.
- Mësojini fëmijët për sigurinë në internet. Është thelbësore të edukohen fëmijët se si të jenë të sigurt në internet. Stafi i shkollës duhet t'i mësojë fëmijët të shmangin ndarjen e informacioneve personale si emri i tyre i plotë, adresa, numri i telefonit dhe adresa elektronike. Fëmijët gjithashtu duhet të mësohen të mos ndajnë foto ose video personale pa lejen e prindërve ose kujdestarëve të tyre.
- Inkurajoni fëmijët të jenë të përgjegjshëm në internet. Stafi i shkollës duhet t'u mësojë fëmijëve rëndësinë e respektimit të privatësisë dhe pronës intelektuale të të tjerëve. Fëmijët gjithashtu duhet të mësohen të raportojnë çdo sjellje ose përmbajtje të dyshimtë te një i rritur i besuar, qoftë prind mësimdhënës, vëlla, motër etj.).
- Është e domosdoshme të monitorohet aktiviteti i fëmijëve në internet për të garantuar sigurinë e tyre. Stafi i shkollës duhet të vëzhgojë atë që fëmijët po bëjnë në internet gjatë kohës së shkollës, me kë po ndërveprojnë dhe çfarë informacioni po ndajnë.
- Krijoni një plan për parandalimin e bullizmit dhe dhunës digjitale. Ngacmimi digjital, kibernetik është një shqetësim në rritje te fëmijët. Shkollat duhet të kenë një plan për parandalimin e bullizmit digjital, kibernetik. Stafi i shkollës duhet t'i mësojë fëmijët të njohin bullizmin kibernetik dhe si t'ia raportojnë atë një të rrituri (stafit të shkollës, prindit, kujdestarit ligjor etj.). Për më tepër, shkolla duhet të ketë politika për të adresuar incidentet e bullizmit në internet.
- Përfshini prindërit dhe kujdestarët, sepse ata luajnë një rol vendimtar në mbrojtjen e fëmijëve të tyre në internet. Stafi i shkollës duhet të sigurojë burime për t'i ndihmuar ata të monitorojnë aktivitetin e fëmijëve të tyre në internet.

Përfundim

Mbrojtja e fëmijëve në internet është një përgjegjësi e përbashkët. Duke krijuar një mjedis të sigurt; duke edukuar fëmijët për sigurinë në internet; duke inkurajuar sjellje të përgjegjshme në internet; duke monitoruar aktivitetin e tyre në internet; duke krijuar një plan parandalimi të bullizmit kibernetik dhe duke përfshirë prindërit dhe kujdestarët, stafi i shkollës mund të ndihmojë që fëmijët të jenë të sigurt në internet.

Linqe të rëndësishme:

1. U.A. 01/2019 PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË INTERNET

<https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2019-per-mbrojtjen-e-femijeve-nxeneseve-ne-internet-ne-institucionet-e-apu/>

2. PAKOJA E UDHËZUESVE “UDHËTIMI NËPËR INTERNET” (2 UDHËZUES PËR NXËNËS, 1 PËR MËSIMDHËNËS DHE 1 PËR PRINDËR)

- <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-nxenes-femije-te-klasave-3-5-te-arsimit-fillor/>
- <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-femije-nxenes-2/>
- <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-mesimdhenes-2/>
- <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-prinder/>



MODULI

PARANDALIMI I DISKRIMINIMIT
NË SHKOLLA

Pse ky modul?

Diskriminimi është një problem i pranishëm në shkolla dhe kudo në shoqëri, që mund të ketë ndikim në suksesin akademik dhe social të nxënësve. Fillimisht duhet kuptuar se diskriminimi është i ndaluar me instrumente ndërkombëtare dhe me ligjet vendore. Si mësues dhe staf shkollor, jeni përgjegjës për të krijuar mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës ku të gjithë fëmijët/nxënësit mund të mësojnë dhe të rriten pa kurrfarë diskriminimi. Në këtë modul, tregohet roli i shkollës në parandalimin e diskriminimit në shkolla dhe ofrohen udhëzime praktike që stafi i shkollës mund t'i zbatojë.

Diskriminimi në kontekstin e shkollës

Diskriminimi në kontekstin e shkollës është trajtimi i ndryshëm ose i pabarabartë ndaj nxënësve, duke i konsideruar si më pak të rëndësishëm, më pak kompetentë, ose në mënyrë të padrejtë të ndikuar nga origjina etnike, gjinore, racore, nga feja, orientimi seksual, statusi social, aftësitë e veçanta ose ndonjë tjetër karakteristikë personale.

Diskriminimi mund të ndodhë në mënyra të ndryshme në shkollë, duke përfshirë:

- Trajtimi i ndryshëm ndaj nxënësve në bazë të origjinës etnike, racës, fesë, orientimit seksual, apo ndonjë karakteristike tjetër personale;
- Mosofrimi i mundësive të barabarta të arsimit për të gjithë nxënësit;
- Ndalimi i ndonjë nxënësi për të marrë pjesë në aktivitete shkollore për shkak të ndonjë karakteristike personale;
- Nënvlërësimi i aftësive apo kompetencave të një nxënësi në krahasim me të tjerët në bazë të ndonjë karakteristike personale;
- Dëmtimi i shumicës në favor të disa nxënësve ose grupeve të caktuara. Ose e kundërta.

Këto veprime diskriminuese mund të kenë pasoja të rënda për nxënësit dhe mund të pengojnë që ata të arrijnë sukses në jetën akademike dhe më pas në jetën profesionale. Shkollat dhe stafi akademik duhet të punojnë së bashku për të krijuar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë nxënësit, pa dallim të asnjë karakteristike personale.

Parandalimi i diskriminimit

Roli i shkollës në parandalim të diskriminimit duhet të shihet në disa drejtime, si në:

- Krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës;
- Edukimin e fëmijëve/nxënësve për diversitetin dhe përfshirjen;
- Reagimin ndaj incidenteve të diskriminimit.

Parandalimi i diskriminimit në shkolla është sfidë e rëndësishme dhe kërkon një përkushtim të vazhdueshëm nga të gjithë aktorët e arsimit. Disa nga alternativat që mund të ndihmojnë në parandalimin e diskriminimit në shkolla janë:

- Krijimi i një klime të mirë të shkollës, ku të gjithë ndihen të barabartë. Në një mjedis të mirë të shkollës, ku nxënësit ndihen të pranuar dhe të respektuar nga bashkëmoshatarët dhe mësuesit, ka më pak gjasa të ketë diskriminim.
- Mund të krijohen politika dhe praktika të drejtpërdrejta për të ndaluar diskriminimin dhe për të trajtuar raste të tilla në mënyrë të drejtë dhe efektive. Kjo nënkupton rregullat e brendshme të shkollës apo edhe masat konkrete brenda Planit zhvillimor të shkollës.
- Zbatimi efikas i kurrikulave që janë gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese. Kurrikula e zbatuar me metodologji që u jep hapësirë të gjithëve në mënyrë të barabartë, mund të ndihmojë në parandalimin e diskriminimit në shkolla, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe të vlerësojnë diversitetin në mënyrë pozitive.
- Forcimi i bashkëpunimit të prindërve dhe komunitetit mund të ndihmojë në parandalimin e diskriminimit në shkolla, duke ndihmuar në ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve brenda institucioneve arsimore.
- Trajnimi dhe zhvillimi i stafit të shkollës mund të ndihmojë në ndërgjegjësimin e tyre rreth çështjeve të diskriminimit dhe në krijimin e aftësive për të trajtuar këto çështje në mënyrë efektive.

Përfundim

Diskriminimi në shkolla është një çështje serioze që mund të ketë efekte afatgjata te nxënësit dhe komuniteti shkollor. Duke kuptuar format e ndryshme të diskriminimit, kuadrin ligjor rreth diskriminimit në shkolla dhe strategjitë praktike për parandalimin e diskriminimit, mund të bëhen ndryshime pozitive në jetën e nxënësve tanë. Në përgjithësi, parandalimi i diskriminimit në shkolla kërkon një përkushtim të vazhdueshëm nga të gjithë aktorët e arsimit dhe një angazhim të përbashkët për të krijuar një mjedis të ndjeshëm dhe të pranueshëm për të gjithë.

Link:

1. LIGJI NR. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

MODULI

PROMOVIMI I BARAZISË
GJINORE

Pse ky modul?

Duke qenë se barazia gjinore është ndër parimet bazë të të drejtave të njeriut, është gjithsesi pjesë integrale e politikave edukative dhe arsimore. Ajo nënkupton mundësitë e barabarta të djemve dhe vajzave, burrave dhe grave në ushtrimin e të drejtave të tyre njerëzore, prandaj roli i shkollës në promovimin e barazisë gjinore është tejet i lartë.

Roli i shkollës në promovimin e barazisë gjinore

Shkolla është vendi ku fëmijët dhe të rinjtë marrin njohuri, por edhe vendi ku marrin një model të sjelljes dhe përvetësojnë vlera, mendime e qëndrime mbi jetën dhe shoqërinë. Duke qenë vend i edukimit dhe formësimit të vlerave dhe qëndrimeve, shkolla duhet të jetë një mjedis ku të gjithë nxënësit janë të barabartë dhe ku nuk ka diskriminim për shkak të gjinisë, orientimit seksual, ngjyrës së lëkurës, fesë, apo çfarëdo dallimi tjetër.

Disa nga elementet kryesore që stafi i shkollave duhet t'i ketë parasysh në promovimin e barazisë gjinore janë:

- Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të barabartë për djem e vajza;
- Trajtimi i temave të barazisë gjinore përmes kurrikulës dhe aktiviteteve shtesë;
- Përdorimi i librave dhe materialeve mësimore që tregojnë diversitetet dhe respektojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht gjinisë së tyre;
- Promovimi i rolit të gruas në shoqëri, në ndërtimin e shtetësisë, institucioneve, fushave të ndryshme jetësore;
- Parandalimi i stereotipave gjinorë, duke treguar mundësitë dhe rolet e barabarta të djemve dhe vajzave në familje dhe shoqëri;
- Promovimi i shkathtësive dhe talenteve të nxënësve, pa diskriminim gjinor;
- Bashkëpunimi me prindërit, komunitetin, ekspertët e fushës në promovimin e barazisë gjinore;
- Inkurajimi i djemve dhe vajzave për respektimin e ndërsjellë dhe promovimin e vlerave të qytetërimit demokratik;
- Shmangia e dhunës, abuzimit dhe ngacmimeve me bazë gjinore etj.

Përfundim

Është e rëndësishme që stafi edukativ-arsimor, udhëheqës e mbështetës të jenë proaktivë në promovimin e vlerave shoqërore ku barazia gjinore ndihet dhe respektohet në secilin segment. Institucioni edukativo-arsimor duhet të jetë vendi ku të gjithë ndihen mirë, të vlerësuar dhe u jepet mundësia e zhvillimit të barabartë. Përmes sistemit arsimor ku barazia është bazament i vlerave qytetëruese, do të kemi tutje familje të shëndosha dhe shoqëri të zhvilluar.

Linqet:

1. LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

2. PROGRAMI I KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2020-2024

<https://abgj.rks-gov.net/publikimet/107/programi-kosoves-per-barazi-gjinore>

<https://abgj.rks-gov.net/publikimet/105/publikimet-abgj>

MODULI

PARANDALIMI
I GJUHËS SË URREJTJES

Pse ky modul?

Ky modul ndërlidhet edhe me modulet e tjera, sepse ndikon në krijimin e mjedisit shkollor human, miqësor dhe të sigurt.

Parandalimi i gjuhës së urrejtjes

Stafi shkollor ka rol në parandalimin e gjuhës së urrejtjes, nëpërmjet edukimit cilësor dhe kultivimit të vlerave të qytet-ërimin demokratik. Shihni në vijim disa nga sugjerimet dhe udhëzimet e vlefshme:

- Trajnimi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen, ku në shkollat ofrohen trajnime për diversitetin dhe përfshirjen për fëmijët/nxënësit dhe stafin për të promovuar ndërgjegjësimin dhe kuptimin e kulturave, racave dhe feve të ndryshme. Kjo mund të përfshijë seminare dhe forma të tjera trajnimi që mësojnë ndjeshmërinë, respektin dhe mirëkuptimin;
- Programet kundër bullizmit që shkollat mund të zbatojnë rregullisht, duke ua shpjeguar pasojat e ngacmimit dhe diskriminimit. Këto programe mund të edukojnë fëmijët/nxënësit mbi efektet e dëmshme të gjuhës së urrejtjes dhe të ofrojnë mjete për të ndërhyrë dhe raportuar incidentet e mundshme;
- Edukimi i bashkëmoshatarëve, ku në shkolla mund të trajnojnë drejtuesit e fëmijëve/nxënësve që të bëhen avokatë të tolerancës dhe respektit. Këta fëmijë/nxënës mund të mësohen të njohin gjuhën e urrejtjes dhe si të ndërhyjnë në një mënyrë të sigurt dhe efektive;
- Dialogu dhe diskutimi, ku në shkolla mund të krijojnë hapësira të sigurta për nxënësit që të kenë biseda të hapura dhe të sqarta rreth gjuhës së urrejtjes dhe ndikimit të saj. Kjo mund të përfshijë diskutime të lehtësuara, debate dhe forma të tjera dialogu që i lejojnë fëmijët/nxënësit të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të mësojnë nga të tjerët.
- Edukimi në mediet sociale, ku në shkolla edukohen fëmijët/nxënësit për përdorimin e përgjegjshëm të medieve sociale dhe se si të luftojnë gjuhën e urrejtjes në internet. Kjo mund të përfshijë mësimet mbi qytetarinë digjitale, privatësinë dhe sigurinë, si dhe strategji për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes në internet;
- Partneritetet në komunitet, ku stafi i shkollave mund të bashkëpunojë me organizatat lokale dhe drejtuesit e komunitetit për të promovuar tolerancën dhe respektin. Kjo mund të përfshijë programe në terren, shërbim në komunitet dhe forma të tjera bashkëpunimi që promovojnë një kulturë të përfshirjes dhe pranimit.

Përfundim

Në përgjithësi, parandalimi i gjuhës së urrejtjes në shkolla kërkon një qasje shumëdimensionale që përfshin edukimin, dialogun dhe përfshirjen e komunitetit. Duke zbatuar këto sugjerime dhe jo vetëm, shkollat mund të krijojnë një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës që nxit respekt dhe mirëkuptim për të gjithë nxënësit.

MODULI

**PARANDALIMI
I DHUNËS NË FAMILJE**

Pse ky modul?

Dhuna në familje prek miliona njerëz në mbarë botën, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë. Si anëtar i stafit të shkollës, ju keni një mundësi unike për të ndihmuar në parandalimin e dhunës në familje duke identifikuar shenjat paralajmëruese dhe duke ofruar mbështetje për ata që kanë nevojë. Ky modul udhëzues është krijuar për t'ju ofruar njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të njohur dhe parandaluar dhunën në familje përmes fëmijëve/nxënësve dhe rasteve që identifikohen në shkolla.

Roli i shkollës karshi këtij problemi shoqëror

Fillimisht duhet njohur se çfarë është dhuna në familje, cilat janë llojet e saj, kush dëmtohet dhe cilat janë pasojat (shih detajet në linqet e mëposhtme).

Roli i stafit të shkollës karshi dhunës në familje është në parandalim, referim dhe raportim.

Parandalimi

Parandalimi i dhunës në familje ushtrohet nëpërmjet edukimit cilësor të gjeneratave të reja, te të cilat kultivohen vlerat humane e qytetëruese, mbi të cilat zhvillohen dhe formësohen individët e suksesshëm, qytetarët e përgjegjshëm në një shoqëri paqësore dhe demokratike.

Rëndësia e programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit në parandalimin e dhunës në familje është mjaft e madhe, prandaj duhet zgjedhur edhe shembuj dhe modele të programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit për fëmijët/nxënësit, prindërit dhe stafin.

Referimi dhe raportimi

Për ta ushtruar rolin e vet në referim dhe raportim, stafi i shkollës duhet t'i kuptojë shenjat identifikuese të dhunës, si:

Shenjat fizike: mavijosje, prerje dhe lëndime të tjera.

Shenjat emocionale: depresion, ankth dhe vetëbesim të ulët.

Shenjat e sjelljes: izolim, tërheqje dhe agresion.

Pasi të identifikohen shenjat e dhunës në familje te nxënësit, autoritetet e shkollës duhet ta raportojnë rastin tek autoritetet përkatëse, si rast të dyshuar. Autoritetet kompetente janë ato që e kualifikojnë apo jo rastin si rast i dhunës në familje. Në gjithë procesin duhet pasur parasysh konfidencialitetin e rastit/rasteve.

Ofrimi i mbështetjes për viktimat e dhunës në familje

Stafi shkollor duhet t'i trajtojë me kujdes viktimat e dhunës dhe t'u ofrojë përkrahje psiko-sociale në bashkëveprim me stafin mbështetës të shkollës dhe organizatat e profilizuara. Të kuptuarit e ndikimit emocional dhe fizik të dhunës në familje te nxënësit viktimat dhe krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për ta është domosdoshmëri për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre në kontekst shkollor.

Përfundim

Stafi i shkollës ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e dhunës në familje. Duke kuptuar shenjat paralajmëruese të dhunës në familje; duke identifikuar dhe raportuar rastet; duke ofruar mbështetje për viktimat dhe duke zbatuar programe edukimi dhe ndërgjegjësimi, ju mund të ndikoni pozitivisht në jetën e nxënësve tuaj dhe familjeve të tyre.

Linqe:

1. KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS KUNDËR GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

<https://rm.coe.int/168046246b>

2. LIGJI NR. 2004/32, LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS

<https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/1A14F1C9-FBBA-4B4F-AAF4-08BD94F39EC5.pdf>

3. LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18420>

4. PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË

<https://readgur.com/doc/114429/procedurat-standarde-t%C3%AB-veprimit-p%C3%ABr-mbrojtje-nga-dhuna-n...>

5. INFORMATORI PËR STAF SHKOLLOR RRETH ZBATIMIT TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

<https://masht.rks-gov.net/informatori-per-staf-shkollor-rreth-zbatimite-konventes-se-keshillit-te-evropes-perparandalimin-dhe-luften-kunder-dhunesndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>



MODULI

PARANDALIMI I TRAFIKIMIT
TË FËMIJËVE

Pse ky modul?

Trafikimi i fëmijëve është një problem serioz që prek miliona fëmijë në mbarë botën. Është një formë e skllavërisë moderne që përfshin shfrytëzimin e fëmijëve për punë, qëllime seksuale ose lloje të tjera shfrytëzimi. Stafi i shkollës luan një rol kritik në parandalimin e trafikimit të fëmijëve, pasi ata shpesh janë në një pozicion unik për të identifikuar dhe raportuar rastet e mundshme të trafikimit. Ky modul udhëzues është krijuar për t'i ofruar personelit të shkollës njohuritë që u nevojiten për të parandaluar trafikimin e fëmijëve në komunitetet e tyre.

Roli i shkollës në parandalim

Shkolla ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e trafikimit të njerëzve, veçanërisht të fëmijëve dhe të rinjve. Në vijim janë disa mënyra që stafi i shkollës mund të ndihmojë, përmes veprimeve institucionale si:

- Aktivitetet kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare në trajtim të temës kundër trafikimit me njerëz;
- Programet edukative dhe sensibilizuese për nxënësit në lidhje me rrezikun e trafikimit të njerëzve dhe se si të mbrohen nga ky fenomen. Këto programe mund të përfshijnë këshilla praktike, si p.sh.: "Mos fol në internet me persona të panjohur!" dhe "Raporto çdo incident të dyshimtë te mësuesit apo stafi i shkollës!";
- Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin për të ndihmuar në ngritjen e vetëdijesimit për rrezikun e trafikimit të njerëzve dhe si t'i shmangen fëmijët nga mashtrimet, joshjet nga njerëzit e panjohur e të rrezikshëm. Kjo mund të përfshijë organizimin e seminareve dhe takimeve për prindërit, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për këtë çështje dhe jo vetëm;
- Identifikimi dhe dokumentimi nëse një nxënës ka ndonjë shenjë apo predispozitë të trafikimit. Nëse ka dyshim të bazuar, stafi i shkollës vazhdon tutje me raportim dhe referim sipas legjislacionit në fuqi. Kjo mund të përfshijë njoftimin e policisë dhe mbështetjen psikologjike dhe sociale të nxënësit në nevojë;
- Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive dhe të shëndetshme mes nxënësve dhe stafit të shkollës mund të ndihmojë në zbulimin e më shumë informacioneve për çdo incident të mundshëm të trafikimit të njerëzve dhe në ndërtimin e besimit dhe besueshmërisë ndërmjet nxënësve dhe stafit të shkollës.

Përfundim

Në përgjithësi, shkolla mund të luajë një rol të rëndësishëm në parandalimin e trafikimit të njerëzve duke ndihmuar në edukimin dhe sensibilizimin e nxënësve dhe komunitetit për këtë dukuri, ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme në rastet e dyshimta dhe ndërtimin e marrëdhënieve pozitive mes nxënësve dhe stafit të shkollës.

Për informacione dhe orientim të mëtejshëm shihni linqet në vijim.

Linqet:

1. LIGJI NR. 04/L-218 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875>

<https://womensnetwork.org/sq/publikimet/>

<https://masht.rks-gov.net/category/te-drejtat-e-njeriut/>



MODULI

**PARANDALIMI
I NGACMIMEVE SEKSUALE**

Pse ky modul?

Parandalimi i ngacmimeve seksuale është një detyrë shumë e rëndësishme për të gjithë stafin e institucionit edukativo-arsimor, sepse fëmijët duhet të jenë të mbrojtur dhe të rriten e zhvillohen në ambient të shëndoshë e të sigurt, larg çdo rrethane që i dëmton. Ky modul ofron këshilla dhe sugjerime që stafi udhëheqës, arsimor, mbështetës dhe të tjerë mund t'i konsiderojë për punën e përditshme.

Roli dhe mundësitë e shkollës në parandalimin e ngacmimeve seksuale

Janë një varg veprimesh e aktiviteteve që stafi edukativ e arsimor mund t'i realizojë nëpërmjet planit mësimor dhe aktiviteteve shtesë, prandaj shih sugjerimet në vijim:

- Stafi shkollor duhet të mbajë seanca edukative për nxënësit rreth sjelljes së duhur ndaj njëri-tjetrit dhe rreth kulturës së respektit dhe tolerancës. Gjithashtu, stafi shkollor duhet të jetë i edukuar në lidhje me këtë temë dhe të mundësojë diskutime të hapura dhe të ndjeshme me nxënësit;
- Duhet punuar me përkushtim rreth trajtimit efikas të temave të edukimit seksual, ngase edukimi i duhur shmang abuzimet dhe përfshirjen në veprime të dëmshme;
- Duhet të ketë politika të qarta rreth sjelljes së duhur dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet mes nxënësve dhe stafit. Këto politika duhet të përfshijnë dhe të dënojnë fort çdo lloj sjelljeje të paligjshme;
- Stafi i shkollës duhet të krijojë një ambient të sigurt për të gjithë nxënësit dhe duhet të ndërmarrë masa për të minimizuar mundësinë e shfaqjes së sjelljeve të paligjshme, ngacmimeve seksuale;
- Stafi i shkollës duhet të trajnohet dhe të ndërgjegjësohet rreth rrezikut të ngacmimeve seksuale dhe duhet të jenë të aftë për të njohur shenjat e ngacmimeve dhe për të ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të ndjeshme nëse ato shfaqen;
- Duhet të ndërmarrë masa për të mbrojtur viktimat e ngacmimeve seksuale dhe duhet të kenë një politikë të qartë dhe të rregullave të qarta për këtë çështje. Shkolla gjithashtu duhet të ofrojë ndihmë dhe mbështetje emocionale dhe psikologjike për viktimat;
- Brenda shkollës duhet të promovohet një kulturë e respektit dhe tolerancës ndaj njëri-tjetrit;
- Në rast se identifikohen raste të ngacmimit, duhet të raportohet sipas legjisllacionit në fuqi. Mosraportimi është vepër penale.

Përfundim

Parandalimi i ngacmimeve seksuale në shkolla kërkon një qasje proaktive që përfshin edukimin e stafit dhe nxënësve, krijimin e një kulture respekti dhe përfshirjeje, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave që mbrojnë të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës. Duke ndërmarrë këta hapa, ne mund të krijojmë mjedise mësimi të sigurta dhe mikpritëse ku të gjithë fëmijët/nxënësit mund të zhvillohen shëndetshëm. MASHTI, Koordinatorja e shkollave promovuese të shëndetit me stafin e kurrikulës dhe në bashkëpunim me UN-FPA-në kanë hartuar pakon e udhëzuesve për edukimin seksual, e cila u shërben mësimdhënësve të të gjitha niveleve arsimore në arsimin parauniversitar që ta trajtojnë këtë temë me qasje kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare, prandaj shihni materialet në linqet në vijim:

Linqet:

1. DORACAK PËR MËSIMDHËNËS PËR EDUKIMIN SEKSUAL, KLASA 1-5:

<https://masht.rks-gov.net/lansohen-doracaket-per-mesimdhenes-per-edukimin-gjitheperfshires-seksual/>

2. DORACAK PËR MËSIMDHËNËS: EDUKIMI SEKSUAL DHE SHËNDETI RIPODHUES (TRUPI IM, NDJENJAT DHE FAMILJA, KLASA 1-5)

<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/doracaku-niveli-1-5.pdf>

3. DORACAK PËR MËSIMDHËNËS: EDUKIMI SEKSUAL DHE SHËNDETI RIPODHUES (PUBERTETI, DASHURIA DHE RELACIONET, KLASA 6-9)

<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/doracaku-6-9.pdf>

4. DORACAK PËR MËSIMDHËNËS: EDUKIMI SEKSUAL DHE SHËNDETI RIPODHUES (I SHËNDOSHË DHE I SIGURT, KLASA 10-12)

<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/booklet-10-12.pdf>

Burime të tjera:

5. DORACAK PËR EDUKIM GJITHËPËRFSHIRËS SEKSUAL PËR BASHKËMOSHATARË – PËRKTHIM NGA GJUHA MAQEDONASE NË GJUHËN SHQIPE:

<https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/SSO-albanska-verzija-7.6.22.pdf>

10 MODULI

**PROGRAMI I INICIATIVËS
SË TË RINJVE - Y RINIA**

Pse ky modul?

Ky modul është produkt i programit rajonal Y Rinia që u zbatua nga *Care International* në shkolla të mesme të larta në Kosovë dhe vende të tjera të rajonit, me qëllim të parandalimit të dhunës në shkollat e mesme të larta të Kosovës, promovimit të mënyrës së shëndetshme të jetesës, barazisë gjinore dhe parandalimit të abuzimit me droga, alkool dhe elemente të tjera negative. Si i tillë moduli është informativ dhe orientues për stafin shkollor, ndërkaq përmbajtja e plotë dhe e detajuar e programit është në linkun e ofruar në faqen e fundit. Duke qenë se është vlerësuar pozitivisht për ndikimin e mirë të rinjtë e shkollave ku u zbatua programi, po e ofrojmë edhe këtu me mundësi zbatimi nga të gjitha shkollat.

Programi është i destinuar për përdorim nga ana e mësimeve, nga stafi profesional, punonjësit shëndetësorë dhe/ose ekspertë të tjerë, edukatorë, trajnerë ose vullnetarë që punojnë me të rinjtë ose dëshirojnë të punojnë me ta.

Programi jep këto alternativa përdorimi dhe mundësi ndikimi:

- Të zhvillohet përmes teknikave dhe strategjive të reja, moderne të mësimit dhe të mësimnxënies, të cilat lehtësojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve të parapara me Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë;
- Të përdoren aktivitete të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë dhe ndikojnë te nxënësit e nivelit të mesëm të lartë në procesin e përmirësimit të barazisë gjinore, uljen e dhunës, dëmet nga abuzimet me droga dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme;
- Të krijojnë në klasë dhe jashtë saj një kulturë të bazuar në të drejtat e njeriut, pa dhunë dhe zhvillimin e shëndetshëm mes të rinjve dhe të rejave dhe të komunitetit në përgjithësi;
- Të rinjtë e moshës 14-18 të mbajnë qëndrime dhe të demonstrojnë sjellje të cilat mbështesin më shumë norma gjinore të barabarta, jetesën e shëndetshme dhe të dekurajojnë sjelljen e dhunshme kundër komunitetit, vajzave dhe bashkëmoshatarëve;
- Të promovojnë aftësitë pozitive jetësore dhe normat e barazisë gjinore për një kalim të shëndoshë të nxënësve nga adoleshenca në moshën madhore.

Qasja holistike në të cilën është i bazuar Programi Y Rinia dhe metodologjia e definuar interaktive, e cila është e integruar në të gjitha aktivitetet e Programit kontribuon në realizimin e qëllimit gjithëpërfshirës përmes fuqizimit të njohurive të nxënësve/eve (zhvillimi kognitiv), pranimin e aftësive të reja dhe fuqizuese jetësore (zhvillimi i sjelljeve) dhe ndryshimi/pranimi i vlerave dhe qëndrimeve (zhvillimi afektiv/emocional).

Programi përbëhet nga dy seksione dhe katër pjesë tematike:

SEKSIONI 1 – PROGRAMI TRANSFORMATIV Y me këtë përmbajtje:

- Hyrje
- Parathënie
- Historia e Programit Iniciativa e burrave të rinj
- Baza edukative
- Pse të fokusohemi te normat gjinore?
- Nga Burrat e rinj si pengesë, te Burrat e rinj si aleatë
- Rreth manualit
- Përdorimi i manualit
- Përmbledhje videosh: “Na ishte njëherë një djalë” dhe “Na ishte njëherë një vajzë”
- Modalitetet e klasave/realizimi i seminareve
- Rezultatet e pritura dhe rezultatet e të mësuarit

SEKSIONI 2 vazhdon tutje me katër tema të mëdha, si në vijim:

1. Zhvillimi i identitetit; Identitet, ndjesi dhe ndjenja dhe Gjinia dhe normat gjinore;
2. Dhuna është në pah; Nga dhuna te bashkëjetesa paqësore, Nga dhuna te respekti në marrëdhënie intime, vetëkontrolli dhe menaxhimi i emocioneve dhe Substancat psiko-aktive;
3. Seksualiteti dhe mbrojtja e të drejtave seksuale dhe riprodhuese; Seksualiteti i shëndetshëm, shtatzënitë adoleshente dhe të drejtat e shëndetit riprodhues dhe seksual, shtatzënia, po apo jo, infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS;
4. Prindërit e shekullit XXI, Atësia dhe amësia dhe Bëhu ndryshimi të cilin e synon.

Përfundim

Brenda këtij programi ka tema të nevojshme për t’u trajtuar në kontekst të shkollës me nxënës të moshave nga 14 e tutje, por edhe me grupe të të rinjve në aktivitetet e tjera ndërgjegjësuese që profesionistë të fushave mund t’i realizojnë në qendra rinore apo brenda organizimeve të ndryshme vullnetarësh.

Koncepte, vlera, qëndrime, rezultate, udhëzime metodologjike, ilustrime, burime dhe detaje të tjera mund t’i gjeni në manualin e plotë të këtij programi, në linkun në vijim:

<https://youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2018/12/Y-TOOLKIT-ALB-WEB.pdf>

MODULI

PARANDALIMI I MARTESAVE
TË HERSHME

Pse ky modul?

Shkolla ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e martesave të hershme duke ofruar edukim dhe informacion të nevojshëm për të rritur vetëdijen e nxënësve mbi pasojat e martesës së hershme në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. Ky modul jep ide se si shkolla mund të ndihmojë në parandalimin e martesave të hershme.

Roli i shkollës në parandalimin e martesave të hershme

Stafi i shkollës duhet të ofrojë programe e aktivitete për të rritur vetëdijen e nxënësve mbi marrëdhëniet e shëndetshme dhe të rrezikshme. Kjo mund të përfshijë temat si ndryshimi midis dashurisë dhe kontrollit, ndikimi i kulturës dhe normave sociale në marrëdhëniet ndërnjerëzore, dhe si të mbrohen nga dhuna në marrëdhëniet me të tjerët dhe në detyrimin për martesë të hershme. Në vijim gjeni disa ide për punën e stafit të shkollës:

- Mësimdhënësit mund të ndihmojnë në rritjen dhe zhvillimin e vetëdijes së nxënësve duke ofruar aktivitete të ndryshme për zhvillimin personal dhe profesional;
- Duhet edukuar fëmijët për pasojat e martesave të hershme në jetën e tyre, si në aspekt fizik, shëndetësor, intelektual, social e emocional;
- Përqendrimi në arsimin dhe trajnimin e vajzave dhe grave është domosdoshmëri. Kur vajzat dhe gratë arsimohen dhe e zhvillojnë karrierën e tyre, ato kanë më shumë mundësi për të kuptuar rëndësinë e një martese të shëndetshme;
- Nëpërmjet mësimdhënies cilësore mund të ofrohet edukim për nxënësit në lidhje me seksualitetin dhe shëndetin riprodhues. Ky lloj edukimi mund të ndihmojë në parandalimin e shtatzënive të hershme dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, duke u lejuar nxënësve të bëjnë zgjedhje të zgjuara për marrëdhëniet e tyre;
- Duhet identifikuar shenjat e fëmijëve që kanë predispozita të martesave të hershme;
- Duhet evidentuar dhe raportuar rastet sipas legjislacionit në fuqi.

Pasojat e martesës së hershme

Martesa e hershme i referohet një martese që bëhet para moshës 18 vjeç dhe ka pasojat të rënda për mirëqenien fizike, emocionale dhe psikologjike të të rinjve. Nuset fëmijë kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje, të kenë qasje të kufizuar në arsim dhe mundësi punësimi, si dhe të kenë rezultate të dobëta të shëndetit riprodhues.

Martesa e hershme duhet të jetë shqetësim për stafin e shkollës për disa arsye: Së pari, ndikon në performancën akademike të fëmijëve/nxënësve që mendojnë të martohen në moshë të re. Së dyti, mund të çojë në braktisje dhe rritje të mungesës në shkollë. Së treti, është shkelje e të drejtave të njeriut dhe bie ndesh me parimet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të vajzave dhe grave.

Identifikimi i shenjave të martesës së hershme dhe si të ndërhyhet

Stafi i shkollës duhet të jetë vigjilent për shenjat e martesës së hershme, të cilat përfshijnë:

- Mungesa të shpeshta në shkollë;
- Ndryshime të menjëhershme në sjellje, të tilla si tërheqje në vete ose sjellje depresive;
- Angazhimi në aktivitet seksual në moshë të re;
- Zbulimi i planeve për t'u martuar.

Nëse një anëtar/e i/e stafit të shkollës dyshon se një nxënës/e mund të jetë në rrezik të martesës së hershme, ai/ajo duhet të:

- raportojë shqetësimet te drejtori i shkollës e më tej te familja dhe Qendra për punë sociale;
- t'i ofrojë fëmijës/nxënësit informacion rreth rreziqeve dhe pasojave të martesës së hershme;
- të udhëzojë fëmijën/nxënësin/en në shërbimet përkatëse mbështetëse, të tilla si këshillimi social, këshillimi ligjor ose shërbimet tjera sociale;
- të iniciojnë mbështetje për fëmijën/nxënësin/en që mund të jetë në rrezik të martesës së hershme.

Përfundim

Martesa e hershme është shkelje e të drejtave të njeriut dhe ka pasoja të rënda për mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve. Si staf arsimor, keni përgjegjësinë të siguron që fëmijë/nxënësit tuaj të jenë të vetëdijshëm për rreziqet që lidhen me martesat e hershme dhe të jenë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të informuara për të ardhmen e tyre. Duke identifikuar shenjat e martesës së hershme dhe duke ofruar burime dhe mbështetje, mund të ndihmohet në parandalimin e martesës së hershme dhe promovimin e mirëqenies së fëmijë/nxënësve tanë.

12 MODULI

**PARANDALIMI
I PUNËS SË FËMIJËVE**

Pse ky modul?

Puna e fëmijëve është një problem serioz që prek miliona fëmijë në mbarë botën. Është e rëndësishme që shkollat të marrin një rol aktiv në parandalimin e punës së fëmijëve, si në komunitetet e tyre, ashtu edhe globalisht. Ky modul jep udhëzime për stafin shkollor me qëllim të parandalimit të punës së rrezikshme dhe të ndaluar për fëmijë.

Roli i shkollës në parandalimin e punës së fëmijëve

Parandalimi i përfshirjes së fëmijës në punë të rrezikshme apo të detyrueshme bëhet nëpërmjet trajtimit efikas të kësaj teme me kurrikulat arsimore, por edhe me parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit, sepse fëmijët e përfshirë në punë janë dhe duhet të konsiderohen si kategori në rrezik të braktisjes. Në vijim mund të shihni masat apo veprimet e mundshme për zbatim në kontekst të shkollave:

- Stafi i shkollës mund të rrisë ndërgjegjësimin për punën e fëmijëve dhe ndikimin e saj negativ në shëndetin, edukimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve. Ata mund të organizojnë seminare dhe programe të tjera arsimore për të edukuar fëmijët/nxënësit dhe prindërit për rreziqet e punës së fëmijëve;
- Shkollat duhet të krijojnë mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse të të mësuarit që janë të lira nga çdo formë abuzimi, shfrytëzimi ose diskriminimi. Fëmijët/nxënësit që ndihen të sigurt dhe të mbështetur kanë më pak gjasa të braktisin shkollën dhe të përfshihen në punën e fëmijëve;
- Arsimi është njëra nga mënyrat më efektive për të parandaluar punën e fëmijëve. Shkollat duhet të përpiqen të ofrojnë qasje në arsim cilësor për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga prejardhja e tyre ekonomike apo sociale;
- Stafi i shkollës duhet të trajnohet për të identifikuar nxënësit në rrezik që mund të jenë të cenueshëm ndaj punës së fëmijëve. Kjo përfshin fëmijët/nxënësit që vijnë nga familje të varfra, kanë qasje të kufizuar në arsim ose jetojnë në zona me shkallë të lartë të punës së fëmijëve;
- Stafi i shkollës duhet t'i njohë format e rrezikshme të punës dhe punët e ndaluara për fëmijët, ashtu që t'ua tregojë fëmijëve pasojat e përfshirjes në ato punë, pavarësisht statusit social të tyre (I kemi parasysh pasojat në zhvillim fizik, intelektual, social e emocional, përfshirë dhe pasojat ligjore për prindërit e tyre);
- Stafi i shkollës mund të bashkëpunojë me komunitetin për të adresuar shkaqet kryesore të punës së fëmijëve. Kjo përfshin angazhimin për politika dhe programe që promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe krijimin e mundësive ekonomike që ndihmojnë familjet të shmangin nevojën për t'u mbështetur në punën e fëmijëve të tyre;
- Stafi i shkollës duhet të jetë vigjilent dhe të raportojë çdo rast të dyshuar të punës së fëmijëve tek autoritetet përkatëse. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve dhe të sigurojë që ata të marrin mbështetjen dhe shërbimet që u nevojiten.

Përfundim

Duke ndjekur këto udhëzime, stafi i shkollës mund të luajë një rol vendimtar në parandalimin e punës së fëmijëve dhe për të siguruar që fëmijët të kenë mundësinë të mësojnë dhe të rriten në mjedise të sigurta dhe mbështetëse. MASHTI në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, zyra në Kosovë, ka siguruar përdorimin e mate-

rialeve të validuara nga UNESCO dhe ka zhvilluar materiale për shkolla, ashtu që puna e fëmijëve të trajtohet me kujdes dhe bazuar në politikat ndërkombëtare dhe nacionale, prandaj shih linqet në vijim.

Linqet:

1. RINIA NË PUNË (Diskutim për sigurinë)

<https://masht.rks-gov.net/rinia-ne-pune/>

2. SCREAM - MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - PAKETËS DIDAKTIKE

https://www.ilo.org/ipecc/Informationresources/WCMS_IPEC_PUB_5807/lang--en/index.htm

3. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - TREGU I PUNËS

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-tregu-i-punes/>

4. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - INTEGRIMI I KOMUNITETIT

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-integrimi-i-komunitetit/>

5. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - DRAMATIZIMI

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-dramatizimi/>

6. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - MJETET E KOMUNIKIMIT, SHTYPI

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-mjetet-e-komunikimit-shtypi/>

7. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - MJETET E KOMUNIKIMIT, RADIOJA DHE TELEVISIONI

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-mjetet-e-komunikimit-radioja-dhe-televizioni/>

8. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - DEBATI

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-debati/>

9. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - SHKRIMI KRIJUES

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-shkrimi-krijues/>

10. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - KONKURSI ARTISTIK

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-konkursi-artistik/>

11. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - LOJA ME ROLE

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-loja-me-role/>

12. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - FIGURA

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-figura/>

13. INTERVISTA DHE SONDAZHE

<https://masht.rks-gov.net/intervista-dhe-sondazhe/>

14. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS - NDAL PUNËS SË FËMIJËVE - KOLAZH

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias-ndal-punes-se-femijeve-kolazh/>

15. KËRKIMI DHE INFORMACIONI

<https://masht.rks-gov.net/kerkimi-dhe-informacioni/>

16. UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E MODULEVE

<https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-zhvillimin-e-moduleve/>

17. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS

<https://masht.rks-gov.net/mbrojtja-e-te-drejtave-te-femijeve-nepermjet-edukimit-artit-dhe-medias/>

Përdorimi i moduleve në ngritjen e kapaciteteve të mësimit dhe subjekteve të tjera të institucioneve arsimore

Të gjitha modulet e kësaj pakoje dhe jo vetëm, mund të përdoren edhe në kuadrin e trajnimeve për mësimit, sipas formave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, prandaj për alternativat e trajnimeve dhe procedurat e realizimit, shihni në vijim informacionin e përmbledhur dhe linqet që tregojnë legjislacionin dhe politikën e përcaktuara nga MASHTI.

Për programin Y Rinia dhe pakon e moduleve të MASHTI-t duhet të ketë trajnime për të gjitha subjektet e institucioneve arsimore: udhëheqës, mësimit, koordinatorë të cilësisë, pedagogë, psikologë, prindër, nxënës. Kjo qasje gjithëpërfshirëse e trajnimeve është e domosdoshme, ngase trajtimi i temave që hyjnë në kuadër të mbrojtjes së fëmijës kërkon kontributin e të gjithëve brenda institucioneve tona.

Kësisoj, si në fazën e zhvillimit të programit të trajnimit duhet të parashihen subjektet e nevojshme dhe të specifikohet ndikimi dhe qasja e integruar e veprimeve në të mirë të mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijës brenda potencialit të plotë.

Zhvillimi profesional i mësimit dhe licencimi

Ngritja e vazhdueshme profesionale është një proces, i cili zbatohet te të gjithë mësimit në botë, në forma të ndryshme, varësisht nga perspektiva e shteteve apo rajoneve.

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësimit dhe licencimi mbeten prioritet i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit krahas vendeve në rajon dhe atyre europiane, duke u mbështetur në nenin 5 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Shih më tej dispozitat kryesore që lidhen me avancimin e mësimit:

Neni 33 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i cili rregullon licencimin e mësimit:

- 1.** Licencimi i mësimit, zhvillimi i kornizës dhe standardet për zhvillim profesional dhe vlerësim të performancës është përgjegjësi e Ministrisë, e cila vepron sipas këshillave dhe rekomandimeve të KSHLM-së.
- 2.** Licencimi i mësimit përcakton kërkesat që duhet plotësuar nga mësimit për të hyrë dhe qëndruar në profesion, si dhe kriteret dhe kërkesat për avancim në sistemin e licencimit.
- 2.** Ministria, përmes aktit nënligjor, sipas këshillave të KSHLM-së, përcakton:
 - 3.3.** kërkesat për zhvillim profesional dhe performancë të mësimit në kuadër të procesit të licencimit;
 - 3.4.** standardet dhe procedurat e akreditimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimit;
 - 3.5.** standardet e praktikës profesionale.

Nga Ligji i Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-032 pastaj burojnë edhe aktet nënligjore dhe Strategjia e arsimit 2022-2026, e lidhur me Planin e Strategjisë të arsimit 2017-2021. Në Strategjinë e arsimit 2022-2026 janë të parapara edhe prioritetet e zhvillimit profesional sipas fushave prioritare, por nuk pengohen as trajnimet e tjera, të cilat kontribuojnë në ngritje të vazhdueshme të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve përgjatë karrierës. Në plan të veprimit të Strategjisë së Arsimit tek objektivi specifik 2.8. *Zbatimi i plotë i sistemit të licencimit dhe shtimi i mundësive për zhvillim dhe avancim profesional të mësimitdhënësve bazuar në standardet e mësimitdhënies në 2.8.5, 2.8.6, 2.8.8, 2.8.9 si dhe pjesë të tjera që e mbështesin zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, para shërbimit dhe në shërbim.*

Nga ligji janë nxjerrë disa udhëzime administrative si:

- Udhëzimi administrativ – Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimitdhënësve, i cili përcakton dhe mbikëqyr politikën e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe licencimin e tyre.
- Udhëzimi administrativ-05/2017 sistemi i licencimit dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në karrierë, Neni 3. Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në karrierë, ku parashihet zhvillimi profesional i mësimitdhënësve para shërbimit në fazën hyrëse dhe gjatë shërbimit.
- Udhëzimi administrativ-06/2017 për kriteret për aprovimin e programeve për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe punonjësve arsimorë. Në këtë udhëzim administrativ janë përcaktuar procedurat e aplikimit të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare për programet e tyre për zhvillim profesional në karrierën e tyre. Një trajnim duhet të ketë së paku 6 orë në programin e tij. Një ditë ka 6 orë trajnim pastaj varet nga numri i ditëve, apo i orëve, sepse trajnimi mund të realizohet edhe nga 3 orë në ditë e pastaj grumbullohet numri i orëve në totalin e një programi për zhvillimin profesional.
- Udhëzimi administrativ-119/2020 për zhvillimin profesional me bazë në shkollë ku parashihet zhvillimi profesional nga identifikimi i nevojave me bazë në shkollë dhe trajnimi mund të realizohet nga stafi i shkollës e jo vetëm nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare. Kërkesat për zhvillim profesional të mësimitdhënësve sipas nevojave, zhvillohen sipas procedurave brenda shkollës, pastaj adresohen në drejtorinë përkatëse të arsimit për miratim dhe mbështetje financiare.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të mbështesë dhe të ndihmojë mësimitdhënësit në zbatimin e kurrikulës së re të Kosovës, e rishikuar në vitin 2016, me metodologji të reja të mësimitdhënies, teknika të përshtatshme me programet lëndore dhe aktivitetet ekstrakurrikulare, duke sjellë një mësimitdhënie dhe nxënie kreative për nxënësit.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të ndërlidhet me politikën shtetërore të arsimit parauniversitar si kurrikula shkollore, politikën referuese për kompetencat e mësimitdhënësve dhe njohuritë empirike rreth të mësimitdhënësve dhe mësimitdhënies efektive e cilësore.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të bazohet në Kornizën Strategjike për Zhvillimin Profesional të Mësimitdhënësve, e cila shërben si pikë referimi për standardet e profesionit të mësuesisë apo profilin e kompetencave të mësimitdhënësve në faza të ndryshme të karrierës sipas sistemit të licencimit.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të bazohet nga kërkesa dhe jo oferta. Orientimi i ofertave të zhvillimit profesional i mësimitdhënësve ndërlidhet me nevojat dhe kërkesat e mësimitdhënësve, të cilat përcaktohen përmes vlerësimit të nevojave dhe formave të tjera konsultative dhe të planifikimit në nivel shkolle, komune dhe në nivel qendror.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve që zbatohet në Kosovë përfshin ofrimin e programeve nga ofertuesit e jashtëm dhe ofrimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë (ZHPMBSH), përmes qasjes me bazë në shkollë. Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve ofrohet nga organizatat publike që kanë mision zhvillimin e mësimitdhënësve, organizatat joqeveritare që kanë mision arsimin, organizatat ndërqeveritare dhe projektet e ndryshme të arsimit në partneritet me donatorët dhe partnerët zhvillimorë.

Format e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve me bazë në shkollë, realizohet në forma të ndryshme, duke përfshirë:

- Programe/Trajnime në nivel shkolle sipas programit, nga lista e programeve të miratuara nga MASHTI, të përzgjedhura dhe të kontraktuara nga shkolla apo komuna për më shumë se një shkollë;
- Punëtori dhe seminare të organizuara nga vetë shkolla;
- Këshillim dhe mentorim ndërmjet kolegëve;
- Kërkim/hulumtim në veprim nga grupe të mësimitdhënësve.

Të gjitha programet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve duhet të kalojnë në procedurat e aplikimit në MASHTI, të vlerësohen nga komisionet e Këshillimit Shtetëror të Licencimit të Mësimitdhënësve, të aprovohen apo refuzohen. Të gjitha trajnimet monitorohen nga MASHTI, Zyra e trajnimeve dhe Drejtoria Komunale e Arsimit. Bashkëlidhur janë linqet e dokumenteve të cituara më lart.

Të gjitha trajnimet duke u ndarë në prioritare dhe plotësuese, u shërbejnë mësimitdhënësve për ngritje të vazhdueshme në karrierë dhe gradim sipas vlerësimit të performancës dhe akteve ligjore në fuqi.

Linqet:

http://www.mashtgov.net/advCms/documents/03_Ligji_per_arsimin_Parauniversitar_anglisht.pdf

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021-1.pdf>

1. STRATEGJIA E ARSIMIT 2022-2026

<https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

2. STRATEGJIA E ARSIMIT 2022-2026, PLANI I VEPRIMIT

<https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit-2022-2026plani-i-veprimit/>

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

3. UA ME NR. 5/2017 SISTEMIMI I LICENCIMIT DHE ZHVILLIMIT TË MËSIMDHNËSVE NË KARRIERË

<https://masht.rks-gov.net/ua-me-nr-5-2017-sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere/>

4. UDHEZIM ADMINISTRATIV MASHTI NR. 13 /2023 PËR KËSHILLIN SHTETËROR PËR LICENCIMIN E MËSIMDHNËSVE

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-13-2023-per-keshillin-shteteror-per-licencimin-e-mesimdhenesve/>

5. UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 12 /2023 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E APROVIMIT TË PROGRAMEVE PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE PUNONJËSVE ARSIMORË

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-nr-12-2023-per-kriteret-dhe-procedurat-e-aprovimit-te-programeve-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve-dhe-punonjesve-arsimore/>

6. UDHËZIM ADMINISTRATIV MASHTI NR. 16/ 2023 PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/>

Përfundim

Në formatin siç janë ofruar këto module, janë bazë e mirë për informimin dhe orientimin e mësimeve dhe kuadrit tjetër të shkollave tona për të punuar dhe ushtruar rolin e tyre në parandalimin e dukurive negative që dëmtojnë dhe pengojnë fëmijët për t'u zhvilluar, edukuar e arsimuar siç duhet. Duke punuar në këto fusha sipas rolit të sektorit arsimor, arrihet rritja e përkushtimit dhe e përbushjes së detyrimit institucional në mbrojtjen e fëmijës nga format e ndryshme të dhunës, abuzimit dhe keqpërdorimit. Mbrojtja e fëmijës është përgjegjësi e secilit institucion, përfshirë institucionin arsimor, prandaj pakoja e këtyre moduleve është ndihmesë dhe mbështetje për kuadrin arsimor, në të mirë të interesit më të lartë të fëmijëve tanë.

Duke i edukuar dhe arsimuar fëmijët, si dhe duke siguruar edhe mbrojtjen e tyre nga elementët që e pengojnë zhvillimin e tyre të plotë, institucionet tona krijojnë mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm e të shëndetshëm të fëmijëve, familjeve dhe shoqërisë sonë.

Ky manual është mbështetur nga Care International në Ballkan së bashku me partnerët SIT dhe YMCA, përmes fondeve nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Ministrisë së Edukimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë dhe jo domosdoshmërisht reflekton pozitën e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.